



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 253

Tiranë – E mërkurë, 28 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 69, datë 6.12.2016	Autorizim i ndihmës shtetërore për ndërmarrjet <i>Start-Up</i> 25437
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 71, datë 6.12.2016	Autorizim i ndihmës shtetërore nëpërmjet pjesëmarrjes në kapital..... 25439
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 72, datë 12.12.2016	Për autorizimin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit në mbështetje të mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që ushtrojnë aktivitet në zonat turistike/historike”..... 25441
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 73, datë 12.12.2016	Autorizim i dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanatit)”..... 25444
Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 74, datë 12.12.2016	Autorizim i ndihmës shtetërore nëpërmjet mbështetjes financiare të projekteve në sektorin e turizmit..... 25446
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 44, datë 14.10.2016	Për licencim për herë të parë për sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vorë..... 25450
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 45, datë 14.10.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 21, datë 30.4.2013, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Delvinë”..... 25450

Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 49, datë 2.12.2016	Për licencimin për herë të parë të sh.a. Ujësjetës-Kanalizime Belsh.....	25450
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 50, datë 2.12.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 20, datë 30.4.2013, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjetës-Kanalizime Mat”	25451
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 51, datë 2.12.2016	Për licencimin e sh.a. Ujësjetës Malësi e Madhe.....	25451



VENDIM
Nr. 69, datë 6.12.2016
AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE PËR NDËRMARRJET
START-UP

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Znj. Milva Ekonomi kryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;
- Z. Petrit Bakiu anëtar;
- Z. Gramoz Hoxha anëtar.

Në mbledhjen e tij të datës 6.12.2016, shqyrtoi masën e sipërpërmendur, të njoftuar nga Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal dhe vendosi të konsiderojë ndihmën në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

I. PROCEDURA

1. Me shkresën nr. 76, datë 2.12.2016, Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER) njoftoi pranë Sektorit të Kontrollit të Ndhmës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) masën e sipërpërmendur.

II. PËRSHKRIMI I MASËS

a) Objektivi i masës së ndihmës

2. Qëllimi i ndihmës është përmirësimi i ekonomisë në Shqipëri përmes mbështetjes financiare të ndërmarrjeve *start-up*.

b) Baza ligjore

3. Baza ligjore është vendimi i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 21, datë 18.4.2016, pika 3.

c) Dhënësi i ndihmës

4. Dhënës i ndihmës është Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, ndërsa zbatues i skemës është Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER).

ç) Instrumenti i ndihmës

5. Ndihma do të jepet në formën e granteve direkte.

d) Buxheti dhe kohëzgjatja e ndihmës

6. Vlera gjithsej e parashikuar për mbështetjen e ndërmarrjeve në formën e grantit të drejtpërdrejtë është 50 000 000 lekë. Burimet financiare për financimin e ndërmarrjeve mund të jenë:

a) kontribut nga buxheti i shtetit;

b) të ardhurat e veta, nga mjete dhe/ose burime të tjera financiare, nëpërmjet:

i) kontributit nga programe të ndihmës së huaj, sipas marrëveshjeve me partnerët e huaj për zhvillim dhe integrim;

ii) kostove të menaxhimit, për programe apo projekte që ata zhvillojnë, me disa përfitues;

iii) burime të tjera të ligjshme, si donacione etj.

Masa do të zbatohet për periudhën 2016–2017.

e) Përfituesit e ndihmës

7. Masa ka për qëllim të shoqërojë investimet infrastrukturore, vendore dhe rajonale, me masa nxitëse ndaj aktiviteteve ekonomike brenda dhe rreth zonës ku do të investohet, sipas objektivave të politikës së zhvillimit rajonal; të nxitë krijimin e partneriteteve ndërvendore dhe rajonale me partnerë publikë dhe privatë; të financojë projektet zhvillimore, të cilat nxitin zhvillimin e ekonomisë rajonale dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

8. Ndihma në formën e grantit të drejtpërdrejtë për ndërmarrjet *start-up*, ku parashikohet të jenë përfitues 1 deri në 10 ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

ë) Aktivitet të cilat përfitojnë ndihmën shtetërore

9. Një ndërmarrje e re *start-up* do të përfitojë ndihmë shtetërore nëse do të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- është ndërmarrje e klasifikuar si ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar;

- ka selinë ose vendin kryesor të prodhimit brenda territorit të rajonit;

- ka paguar të gjitha detyrimet e parashikuara nga legjislacioni doganor dhe tatimor;

- është në gjendje të financojë 50% të të gjitha kostove të projektit në fazën e aplikimit.

III. VLERËSIMI I NDIHMËS SHTETËRORE

a) Ndihmë shtetërore e drejtpërdrejtë për ndërmarrjet

10. Neni 4, i ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, parashikon se: “Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo lloji forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të



shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

11. Masa e njoftuar mundëson përfitimin e burimeve financiare vetëm për një numër të caktuar ndërmarrjesh të vogla dhe të mesme me një aktivitet të caktuar ekonomik. Autoriteti publik (AZHER) do t'i ofrojë këtyre ndërmarrjeve burime financiare me kushte më të mira se sa ato që ofrohen në treg. Si rrjedhim, skema ofron një avantazh/përparësi gjatë procesit të përzgjedhjes së tyre. Produktet dhe shërbimet e ndërmarrjeve të përzgjedhura mund të jenë pjesë e tregut të përbashkët rajonal, duke përmirësuar pozitën konkurruese të tyre dhe më pas ndikuar në tregtinë rajonale.

12. Komisioni arrin në përfundimin se masa, në interpretimin që u bëhet akteve dhe fakteve të sipërpërmendura, është ndihmë shtetërore.

b) Përputhshmëria e skemës së ndihmës shtetërore

13. VKM-ja nr. 580, datë 3.8.2016, pika 4.4, parashikon se:

“Për skemën instrumenteve të financimit për bizneset *start-up*, në varësi të vlerësimit për projektin e dorëzuar, aplikanti përfiton deri në 50% të vlerës totale të investimit, por jo më shumë se 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë/projekti, në këmbim të aksioneve/kuotave të shoqërisë”.

14. Sa më lart, skema e ndihmës ka efekt nxitës, duke qenë se është një burim i konsiderueshëm kapitali për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që në fazën e hershme të krijimit dhe fillimit të funksionimit të biznesit. Si e tillë, skema e njoftuar është në përputhje me nenin 13, shkronja “c” “Ndihma shtetërore që mund të lejohet”, duke qenë se lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 13, 17, shkronja “ç”, 22, pika 2/1, 30 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore për ndërmarrjet *start-up*, të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 3.8.2016, “Për krijimin e programit për mbështetjen e ekonomisë dhe përcaktimin e përfituesve e të rregullave për zbatimin e tij”, mbështetur në nenin 13, germa “c”, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sepse lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER), brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar, si edhe të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

3. Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER), bazuar në nenin 20, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së në rastin eventual të çdo ndryshimi të skemës së njoftuar.

4. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Milva Ekonomi

**VENDIM**

Nr. 71, datë 6.12.2016

**AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE NËPËRMJET
PJESËMARRJES NË KAPITAL**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Znj. Milva Ekonomi kryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;
- Z. Petrit Bakiu anëtar;
- Z. Gramoz Hoxha anëtar.

Në mbledhjen e tij të datës 6.12.2016, shqyrtoi masën e sipërpërmendur, të njoftuar nga Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal dhe vendosi të konsiderojë ndihmën në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

I. PROCEDURA

1. Me shkresën nr. 76, datë 2.12.2016, Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER) njoftoi pranë Sektorit të Kontrollit të Ndihmës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) masën e sipërpërmendur.

II. PËRSHKRIMI I MASËS

a) Objektivi i masës së ndihmës

2. Qëllimi i ndihmës është përmirësimi i ekonomisë në Shqipëri përmes financimit të pjesëmarrjes në shoqëri tregtare në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).

b) Baza ligjore

3. Baza ligjore është vendimi i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 21, datë 18.4.2016, pika 3.

c) Dhënësi i ndihmës

4. Dhënës i ndihmës është Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, ndërsa zbatues i skemës është Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER).

ç) Instrumenti i ndihmës

5. Ndihma do të jepet në formën e pjesëmarrjes në kapital.

d) Buxheti dhe kohëzgjatja e ndihmës

6. Vlëra gjithsej e parashikuar për mbështetjen e ndërmarrjeve në formën e pjesëmarrjes në kapital është 50 000 000 lekë. Burimet financiare për financimin e ndërmarrjeve mund të jenë:

a) kontribut nga buxheti i shtetit;

b) të ardhurat e veta, nga mjete dhe/ose burime të tjera financiare, nëpërmjet:

i) kontributit nga programe të ndihmës së huaj, sipas marrëveshjeve me partnerët e huaj për zhvillim dhe integrim;

ii) kostove të menaxhimit, për programe apo projekte që ata zhvillojnë, me disa përfitues;

iii) burime të tjera të ligjshme, si donacione etj.

Masa do të zbatohet për periudhën 2016–2017.

e) Përfituesit e ndihmës

7. Masa ka për qëllim të shoqërojë investimet infrastrukturore, vendore dhe rajonale, me masa nxitëse ndaj aktiviteteve ekonomike brenda dhe rreth zonës ku do të investohet, sipas objektivave të politikës së zhvillimit rajonal; të nxitë krijimin e partneriteteve ndërvendore dhe rajonale me partnerë publikë dhe privatë; të financojë projektet zhvillimore, të cilat nxitin zhvillimin e ekonomisë rajonale dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

8. Ndihma në formën e pjesëmarrjes në shoqëri tregtare, ku parashikohen të jenë përfitues 1 deri në 10 ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

ë) Aktivitetet të cilat përfitojnë ndihmën shtetërore

9. Një ndërmarrje e vogël dhe e mesme do të përfitojë ndihmë shtetërore nëse do të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- është ndërmarrje e klasifikuar si ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar;

- ka selinë ose vendin kryesor të prodhimit brenda territorit të rajonit;

- ka paguar të gjitha detyrimet e parashikuara nga legjislacioni doganor dhe tatimor;

- është në gjendje të financojë 50% të të gjitha kostove të projektit në fazën e aplikimit.

III. VLERËSIMI I NDIHMËS SHTETËRORE

a) Ndihmë shtetërore e drejtpërdrejtë për ndërmarrjet

10. Neni 4, i ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, parashikon se: “Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo lloji



forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

11. Masa e njoftuar mundëson përfitimin e burimeve financiare vetëm për një numër të caktuar ndërmarrjesh të vogla dhe të mesme me një aktivitet të caktuar ekonomik. Autoriteti publik (AZHER) do t'i ofrojë këtyre ndërmarrjeve burime financiare me kushte më të mira se sa ato që ofrohen në treg. Si rrjedhim, skema ofron një avantazh/përparësi gjatë procesit të përzgjedhjes së tyre. Produktet dhe shërbimet e ndërmarrjeve të përzgjedhura mund të jenë pjesë e tregut të përbashkët rajonal, duke përmirësuar pozitën konkurruese të tyre dhe më pas ndikuar në tregtinë rajonale.

12. Komisioni arrin në përfundimin se masa, në interpretimin që u bëhet akteve dhe fakteve të sipërpërmendura, është ndihmë shtetërore.

b) Përputhshmëria e skemës së ndihmës shtetërore

13. VKM-ja nr. 580, datë 3.8.2016, pika 4.3, parashikon se:

“Për skemën e financimit të pjesëmarrjes në shoqëri tregtare në varësi të vlerësimit për projektin e dorëzuar, aplikanti përfiton, nëpërmjet bashkëfinancimit, në formën e grantit të drejtpërdrejtë, deri në 50% të vlerës totale të investimit, por jo më shumë se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë/projekti”.

14. Sa më lart, skema e ndihmës ka efekt nxitës, duke qenë se është një burim i konsiderueshëm kapitali për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që në fazën e hershme të krijimit dhe fillimit të funksionimit të biznesit. Si e tillë, skema e njoftuar është në përputhje me nenin 13, shkronja “c” “Ndihma shtetërore që mund të lejohet”, duke qenë se lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 13, 17, shkronja “ç”, 22, pika 2/1, 30 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore nëpërmjet pjesëmarrjes në kapital, të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 3.8.2016, “Për krijimin e programit për mbështetjen e ekonomisë dhe përcaktimin e përfituesve e të rregullave për zbatimin e tij”, mbështetur në nenin 13, germa “c”, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sepse lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER), brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar, si edhe të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

3. Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER), bazuar në nenin 20, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së në rastin eventual të çdo ndryshimi të skemës së njoftuar.

4. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Milva Ekonomi



VENDIM

Nr. 72, datë 12.12.2016

PËR AUTORIZIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE “PËR KRIJIMIN E FONDIT NË MBËSHTETJE TË MIKRONDËRMARRJEVE, NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME QË USHTROJNË AKTIVITET NË ZONAT TURISTIKE/HISTORIKE”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Znj. Milva Ekonomi kryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;
- Z. Petrit Bakiu anëtar;
- Z. Gramoz Hoxha anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 12.12.2016, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, mori në shqyrtim “Planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit në mbështetje të mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që ushtrojnë aktivitet në zonat turistike/historike””.

I. PROCEDURA

1. Shqyrtimi i skemës ka filluar nga Drejtoria e Tregut të Brendshëm, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS).

II. PËRSHKRIMI I SKEMËS SË NDIHMËS SHTETËRORE

2. Konteksti: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në cilësinë e dhënësit të ndihmës shtetërore dhe përgjegjës për hartimin e politikave ekonomike e tregtare në mbështetje të biznesit dhe turizmit, ka marrë nismën për krijimin e skemës së ndihmës “Për krijimin e fondit në mbështetje të mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që ushtrojnë aktivitet në zonat turistike/historike”. Qëllimi i skemës së ndihmës është rivitalizimi ekonomik në zonat turistike/historike.

3. Objektivi: Objektivi kryesor i krijimit të Fondit është stimulimi i mikrondërmarrjeve,

ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që ushtrojnë aktivitet në zonat turistike/historike, për t’iu mundësuar atyre mbështetje financiare për investime kapitale në ambientet e ushtrimit të aktivitetit.

4. Baza ligjore: Baza ligjore për dhënien e ndihmës është:

a) Nenet 5 dhe 7, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar.

b) Ligji nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”.

c) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 464, datë 22.6.2016, “Për krijimin e fondit në mbështetje të mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që ushtrojnë aktivitet në zonat turistike/historike”.

5. Dhënësi i ndihmës është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e ndihmës është Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

6. Buxheti dhe mënyra e financimit: Fondi në Mbështetje të Mikrondërmarrjeve, Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, që ushtrojnë aktivitet në zonat turistike/historike, ka një vlerë të përgjithshme 49 000 000 (dyzet e nëntë milionë) lekë, për një kohëzgjatje zbatimi 3-vjeçare, për periudhën 2016–2018. Fondi fillon të zbatohet në vitin 2016 me këtë shtrirje kohore dhe sipas vlerave të mëposhtme:

a) për vitin 2016, vlera e fondit të jetë 29 000 000 (njëzet e nëntë milionë) lekë;

b) për vitin 2017, vlera e fondit të jetë 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

c) për vitin 2018, vlera e fondit të jetë 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

7. Efektet financiare (pika 11 e VKM-së nr. 464/2016), që rrjedhin nga zbatimi i kësaj skeme do të përballohen si më poshtë vijon:

- 29 000 000 (njëzet e nëntë milionë) lekë, nga fondet e planifikuara për AIDA-n, për vitin 2016;

- 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë do të planifikohen në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, për vitet 2017 dhe 2018, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

8. Forma dhe intensiteti i ndihmës: Fondi u jep ndihmë, në formë granti të drejtpërdrejtë, mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të



mesme, nëpërmjet bashkëfinancimit. Në varësi të vlerësimit për projektin e dorëzuar nga përfituesi/ët, Fondi mbulon deri në 50% të kostove të pranueshme, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë) lekë. Kostot e pranueshme, që mund të bashkëfinancohen, përfshijnë kostot, për:

- a) rikonstrukcion të ambienteve të brendshme të vendit të ushtrimit të aktivitetit;
- b) blerje makinerish/pajisjesh;
- c) shërbime këshillimore për projektimin për ristrukturimin dhe modernizimin e ambienteve të punës.

9. Kohëzgjatja: Skema parashikohet të fillojë zbatimin në vitin 2016 dhe të zgjasë për një periudhë 3-vjeçare, deri në vitin 2018.

10. Përfituesit: Përfitojnë nga Fondi ndërmarrjet që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) janë biznese të klasifikuara, si mikro, të vogla apo të mesme, sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar;
- b) kanë selinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- c) ushtrojnë aktivitetin e tyre në një nga zonat turistike/historike;
- d) kanë një kontratë qiraje të paktën dyvjeçare për ambientet ku ushtrohet aktiviteti;
- e) janë të regjistruara në QKB dhe nuk kanë detyrime tatimore e doganore të papaguara;
- f) nuk janë në proces falimentimi ose procedurë likuidimi;
- g) plotësojnë kriteret e legjislacionit të ndihmës shtetërore për ndihmën “De minimis”;
- h) duhet të jenë të afta për të financuar jo më pak se 50% të vlerës së projektit.

III. VLERËSIMI I EKZISTENCËS SË NDIHMËS SHTETËRORE

Vlerësimi i kriterëve që përcaktojnë nëse një masë përbën ndihmë shtetërore do të bëhet bazuar në ligjin nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

11. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen, në mënyrë kumulative, këto kushte:

- a) aktivizohen burime shtetërore;
- b) përfituesit i jepet një avantazh ekonomik në mënyrë selektive; dhe

c) shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën;

d) ka ndikim në tregti.

- “Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”.

Burimet shtetërore

12. Komisioni i Ndhmës Shtetërore konstaton se masa financohet direkt nga buxheti i shtetit shqiptar dhe rrjedhimisht, aktivizohen burime shtetërore.

Bazuar në nenin 2, të ligjit nr. 9374/2005:

“Dhënës të ndihmës shtetërore” janë organet e pushteteve shtetërore dhe të qeverisjes vendore, si dhe çdo ent tjetër që vepron në emër të shtetit, të cilat mund ose janë të autorizuar të japin ndihmë shtetërore.

8. “Burime shtetërore” janë burimet e buxhetit të shtetit, përfshirë të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve, titujt shtetërorë, fondet publike, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, burimet e buxhetit të njërive të qeverisjes vendore, burimet e shoqërive shtetërore, në rastet kur këto burime nuk aktivizohen në përputhje me parimin e investitorit privat në një ekonomi tregu.

Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

13. Skema e ndihmës ka karakter selektiv, sepse prej saj përfitojnë vetëm një numër i kufizuar ndërmarrjesh mikro, të vogla dhe të mesme, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 8 të VKM-së 464/2016, si dhe që janë të lokalizuara në zonat turistike dhe historike. Rrjedhimisht, jo të gjitha ndërmarrjet që operojnë në treg kanë aftësinë për të aplikuar dhe përfituar nga mbështetja financiare. Ndërmarrjet përfituese kanë avantazh ekonomik, kundrejt ndërmarrjeve të tjera, pasi ato marrin nga shteti një ndihmë financiare, që në kushte normale të zhvillimit të veprimtarisë së tyre nuk do ta siguronin.

Shtrembërimi i konkurrencës dhe efekti në tregti

14. Masa e ndihmës ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë



se forcon pozitën ekonomike të ndërmarrjeve fituese kundrejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg.

Konkluzion

i) Sa më sipër, duke qenë se skema u jep ndërmarrjeve përfituese një avantazh ekonomik selektiv, financohet direkt nga buxheti i shtetit, ka efekt në konkurrencë dhe tregti, Komisioni vlerëson se masa përbën ndihmë shtetërore.

IV. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË SKEMËS

Nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson se:

Neni 8 i ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, parashikon se:

“1. Ndhimja “De minimis” është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “De minimis” përcakton vlerën maksimale të lejuar, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës de minimis.

Kreu II i vendimit të KM-së parashikon:

1. Ndhimja lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;

b) Ndhimja është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim rrisht për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Kreu III “Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit”

“1. Granti dhe subvencionin në të holla janë ndihmë transparente”

Sa më sipër, bazuar në ligjin “Për ndihmën shtetërore” dhe vendimin e KM-së nr. 605/2016, ndihimja de minimis lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon 14.000.000 (katërbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet, pasi masa konsiston në dhënien e ndihmës financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në vlerën maksimale prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh për ndërmarrje.

b) Ndhimja duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Kohëzgjatja e të gjithë skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është 3 vjet, duke plotësuar dhe kushtin tjetër ligjor.

c) Ndhimja është transparente. Granti dhe subsida në të holla janë ndihmë transparente. Në rastin konkret, ndihimja jepet në formën e grantit.

Sa më lart, Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerëson se skema e ndihmës shtetërore është në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, nenit 8, nenit 17, nenit 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë skemën e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit në mbështetje të mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që ushtrojnë aktivitet në zonat turistike/historike”, si një skemë ndihme të lejueshme.

2. Çdo plan ndihme, i cili ndryshon masën e ndihmës, lidhur me vlerën, kohëzgjatjen ose kriteret duhet të njoftohet dhe të marrë miratimin e KNSH-së.

3. Çdo përfitues ndihme duhet të nënshkruaj deklaratën e ndihmës “De Minimis” dhe të dorëzojë një të deklaratës pranë AIDA-s.

4. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

5. AIDA të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihimja e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

6. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM****Nr. 73, datë 12.12.2016****AUTORIZIM I DHËNIES SË NDIHMËS
SHTETËRORE “PËR KRIJIMIN E
FONDIT TË EKONOMISË KREATIVE
(ARTIZANATIT)”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Znj. Milva Ekonomi kryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Ahmet Maçellari anëtar;
- Z. Petrit Baku anëtar;
- Z. Gramoz Hoxha anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 12.12.2016, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, mori në shqyrtim planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanatit)”.

I. PROCEDURA

1. Plani për dhënien e ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanatit)” është njoftuar nga Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (më poshtë “MZHETTS”), duke respektuar detyrimin për njoftimin e ndihmës në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

II. PËRSHKRIMI I MASËS

2. Objektivi: Plani për dhënien e ndihmës ka si objektiv mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (SME-ve), për krijimin e kushteve lehtësuese dhe faciliteteve, me qëllim përmirësimin e klimës dhe kushteve të prodhimit dhe marketimit të produkteve artizanale, duke krijuar kështu bazat për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të vendit, zhvillimin e sektorit të artizanatit dhe zejtarisë në Shqipëri dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

3. Baza ligjore për dhënien e ndihmës janë nenet 4, 5, 6, 7, 8 e 9, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar.

4. Kohëzgjatja: Plani i ndihmës parashikohet të fillojë zbatimin në vitin 2017 dhe të zgjasë për një periudhë 3-vjeçare deri në vitin 2019.

5. Dhënësi i ndihmës është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

6. Përfituesit: Përfitojnë nga Fondi i Ekonomisë Kreative ndërmarrjet mikro dhe të vogla, që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

a) Janë ndërmarrje të klasifikuara si mikro ose të vogla, sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar.

b) Kanë selinë ose vendin kryesor të prodhimit brenda territorit të vendit.

c) Prodhonë në Shqipëri produkte, të cilat aktualisht tregtohen brenda vendit, eksportohen jashtë ose krijojnë vende të reja pune.

7. Shtrirja territoriale: Projekti do të zbatohet në të gjithë territorin e Shqipërisë.

8. Vlera e ndihmës/Buxheti i planifikuar/Humbjet në buxhet: Fondi total i ndihmës ka një vlerë të përgjithshme prej 30.000.000 (tridhjetë milionë) lekë, për periudhën 2017–2019. Vlera e fondit për secilin vit do të jetë 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i planit të ndihmës, përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

9. Intensiteti: Në kostot e miratuara që mund të financohen nga skema përfshihen kostot për projektet që përzgjidhen nga sektori i artizanatit dhe që mbulojnë fushat e mëposhtme:

- a) zhvillimin e produkteve të reja;
- b) blerjen e pajisjeve për nxitjen e prodhimit;
- c) marketingun e produktit;
- d) kualifikimin dhe ndërtimin e kapaciteteve njerëzore të ndërmarrjes aplikuese.

10. Forma e ndihmës dhe mjetet e financimi: Ndhimja jepet në formën e grantit të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro dhe të vogla që operojnë në sektorin e artizanatit. Për çdo ndërmarrje përfituese, në varësi të projektit konkurrues të përgatitur nga aplikantët, skema mbulon 80% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 500.000 (pesëqind mijë) lekë.



III. VLERËSIMI I EKZISTENCËS SË NDIHMËS SHTETËRORE

11. Vlerësimi i kriterëve që përcaktojnë nëse një masë përbën ndihmë shtetërore do të bëhet bazuar në ligjin nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe në praktikën administrative të Komisionit Evropian, jurisprudencën e gjykatave të Bashkimit Evropian, sipas parashikime dhe detyrimit që buron nga nenin 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë:

“2. Praktikrat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

12. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen, në mënyrë kumulative, të gjitha këto kushte:

- a) aktivizohen burime shtetërore;
- b) përfituesit i jepet një avantazh ekonomik në mënyrë selektive; dhe
- c) shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën;
- d) ka ndikim në tregti.

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”.

Burimet shtetërore

13. Zbatimi i skemës së njoftuar aktivizon burime shtetërore, sepse financohet direkt nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për ekonominë (MZHETTS).

Bazuar në nenin 2, të ligjit nr. 9374/2005:

1. “Dhënës të ndihmës shtetërore” janë organet e pushteteve shtetërore dhe të qeverisjes vendore, si dhe çdo ent tjetër që vepron në emër

të shtetit, të cilat mund ose janë të autorizuar të japin ndihmë shtetërore.

8. “Burime shtetërore” janë burimet e buxhetit të shtetit, përfshirë të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve, titujt shtetërorë, fondet publike, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, burimet e buxhetit të njëjësive të qeverisjes vendore, burimet e shoqërive shtetërore, në rastet kur këto burime nuk aktivizohen në përputhje me parimin e investitorit privat në një ekonomi tregu.

Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

14. Skema e ndihmës ka karakter selektiv, sepse prej saj përfitojnë vetëm një numër i kufizuar ndërmarrjesh mikro dhe të vogla, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në projekt vendimin e Këshilli të Ministrave “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanatit)”. Përfituesit e financimit publik kryejnë një aktivitet ekonomik në sektorin e artizanatit dhe zejtarisë duke prodhuar produkte, të cilat tregtohen brenda dhe jashtë vendit. Skema favorizon ndërmarrje të caktuara kundrejt ndërmarrjeve të tjera. Masa është selektive dhe i jep një avantazh ekonomik përfituesve të saj, pasi ato marrin nga bashkia një ndihmë financiare, që në kushte normale të zhvillimit të veprimtarisë së tyre nuk mund ta siguronin.

Shtrembërimi i konkurrencës dhe efekti në tregti

15. Masa e ndihmës ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se forcon pozitën ekonomike të ndërmarrjeve fituese kundrejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg. Zbatimi i skemës do të nxisë zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në tregun e artizanatit me qëllim krijimin e produkteve të reja me origjinë shqiptare, për të cilat do të rritet interesi edhe nga ana e turistëve të huaj.

Konkluzion

Sa më sipër, duke qenë se skema u jep ndërmarrjeve përfituese një avantazh ekonomik selektiv, financohet direkt nga buxheti i shtetit, ka efekt në konkurrencë dhe tregti, Drejtoria vlerëson se masa përbën ndihmë shtetërore.

IV. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË SKEMËS

Nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se:

Neni 8 i ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, parashikon:



“1. Ndhimja “De minimis” është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “De minimis” përcakton vlerën maksimale të lejuar, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës de minimis.

Kreu II i vendimit të KM-së parashikon:

1. Ndhimja lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi.

b) Ndhimja është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim rrisht për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Kreu III “Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit”

“1. Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente”

Sa më sipër, bazuar në ligjin “Për ndihmën shtetërore” dhe vendimin e KM-së nr. 605/2016, ndihma de minimis lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon 14.000.000 (katërbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet, pasi masa konsiston në dhënien e ndihmës financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në vlerën maksimale prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh për ndërmarrje.

b) Ndhimja duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Kohëzgjatja e të gjithë skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është 3 vjet, duke plotësuar dhe kushtin tjetër ligjor.

c) Ndhimja është transparente. Granti dhe subsida në të holla janë ndihmë transparente. Në rastin konkret, ndihma jepet në formën e grantit.

Nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, duke qenë në kushtet e përmbushjes së të gjitha kriterëve të përcaktuara nga neni 8, Komisioni vlerëson se skema “Për nxitjen e punësimit në ndihmë të krijimit të biznesit social rinor” është një skemë ndihme që lejohet.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhimës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, VENDOSI:

1. Të autorizojë planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanatit)”.

2. Çdo plan ndihme, i cili ndryshon masën e ndihmës, lidhur me vlerën, kohëzgjatjen ose kriteret duhet të njoftohet dhe të marrë miratimin e KNSH-së.

3. Çdo përfitues ndihme duhet të nënshkruajë deklaratën e ndihmës “De Minimis” (bashkëlidhur) dhe të dorëzojë një kopje të deklaratës pranë AIDA-s dhe një kopje pranë Komisionit të Ndhimës Shtetërore.

4. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.

5. AIDA të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

6. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Milva Ekonomi

VENDIM Nr. 74, datë 12.12.2016

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE NËPËRMJET MBËSHTETJES FINANCIARE TË PROJEKTEVE NË SEKTORIN E TURIZMIT

Komisioni i Ndhimës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|-----------|
| - Znj. Milva Ekonomi | kryetare; |
| - Znj. Mimoza Dhëmbi | anëtare; |
| - Z. Ahmet Mançellari | anëtar; |
| - Z. Petrit Baku | anëtar; |
| - Z. Gramoz Hoxha | anëtar. |



Në mbledhjen e tij të datës 12/12/2016, shqyrtoi “ex-post” masën e sipërpërmendur, të hartuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) dhe vendosi të konsiderojë ndihmën në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

I. PROCEDURA

1. Në zbatim të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, neni 28/1, Sektori i Kontrollit të Ndhimës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) grumbulloi dhe përpunoi të dhënat për mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit të projekteve në fushën e turizmit, në përputhje me rregullat e ndihmës shtetërore. Më pas këto të dhëna iu propozuan Komisionit të Ndhimës Shtetërore për vlerësim dhe autorizimin “ex-post” të skemës së ndihmës shtetërore.

II. PËRSHKRIMI I MASËS

a) Objektivi i masës së ndihmës

2. Qëllimi i ndihmës është mbështetja me fonde publike të projekteve të studimit, promovimit dhe edukimit apo modele inovative të produkteve turistike, në funksion të zhvillimit të turizmit.

b) Baza ligjore

3. Baza ligjore është vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.4.2016, “Për përcaktimin e kritereve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”.

c) Dhënësi i ndihmës

4. Dhënës i ndihmës është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS). Zbatues i skemës është Drejtoria e Përgjithshme e Turizmit në MZHETTS.

ç) Instrumenti i ndihmës

5. Ndhimja do të jepet në formën e financimit nga buxheti i shtetit. Fondet parashikohen dhe miratohen çdo vit në programin “Zhvillimi i Turizmit”, që administrohet dhe menaxhohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Për vitin 2017 janë parashikuar 42 mln lekë nga buxheti i shtetit për mbështetjen e subjekteve që do të ushtrojnë veprimtari ekonomike në fushën e zhvillimit të turizmit. Ndhimja nuk mund të jepet më tepër se një herë në vit për të njëjtin subjekt konkurrues.

d) Intensiteti i ndihmës

6. Vlera gjithsej e parashikuar për mbështetjen e ndërmarrjeve në fushën e turizmit do të financohen nga buxheti i shtetit. Për realizimin e projekteve konkurruese turistike, skema e financimit do të mbulojë deri në 50% të kostove të pranuar e të miratuara nga ministria përgjegjëse për turizmin. Për projektet, për të cilat kërkohet një financim që kalon 50% të fondit buxhetor vjetor të parashikuar në buxhetin e shtetit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

e) Përfituesit e ndihmës

7. Përfituesit janë subjektet që operojnë në fushën e zhvillimit të produkteve turistike.

ë) Aktivitetet të cilat përfitojnë ndihmën shtetërore

9. Një subjekt do të përfitojë ndihmë shtetërore nëse do të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) nuk janë në proces falimentimi dhe se kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

b) nuk janë subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe nuk ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose nuk ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

c) nuk janë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale si person juridik, ortak apo aksionar i shoqërisë;

d) kanë përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

e) kanë përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

III. VLERËSIMI I NDIHMËS SHTETËRORE

a) Ndhimë shtetërore e drejtpërdrejtë për ndërmarrjet

10. Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, parashikon se: “Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo lloji



forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore”.

11. Gjithashtu, në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, neni 71, ndalohet çdo ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të kërcënojë të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose produkte të caktuara, dhe nuk është e pajtueshme me funksionimin e duhur të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, në masën që mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.

12. Së pari, duhet vlerësuar nëse skema shtrembëron apo kërcënon të shtrembërojë konkurrencën. Skema jep një avantazh subjekteve përfituese sikurse përshkruhet në paragrafin nr. 9. Ky avantazh jepet nga burime shtetërore dhe favorizon vetëm ndërmarrjet që operojnë në fushën e turizmit. Mbështetur në faktin e thjeshtë se pozita konkurruese e një ndërmarrjeje forcohet në krahasim me ndërmarrjet e tjera, duke i dhënë asaj një përfitim ekonomik të cilin nuk do ta kishte marrë përgjatë ushtrimit normal të aktivitetit të saj ekonomik, atëherë krijohet një efekt i kufizimit të konkurrencës në treg.

13. Së dyti, duhet vlerësuar nëse efekti i kufizimit të konkurrencës shtrihet dhe mund të ndikojnë deri në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë. Ndihma ka efekt në tregti mes Komunitetit dhe Shqipërisë. Përfituesit e ndihmës ushtrojnë aktivitet ekonomik në një treg që ofron shërbime në fushën e turizmit brenda dhe jashtë vendit. Sektori është i hapur për konkurrencën në nivel evropian dhe si pasojë ndikohet ndjeshëm ndaj çdo mase e cila mbështet prodhimin/shërbimin në një ose disa shtete anëtare.

Komisioni arrin në përfundimin se masa, në interpretimin që u bëhet akteve dhe fakteve të sipërpërmendura, është ndihmë shtetërore.

b) Përputhshmëria e skemës së ndihmës shtetërore

14. Ligji nr. 9374, datë 21.5.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, neni 8, ndihma “De minimis”, parashikon se ndihma është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

15. Në bazë të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, pika II, shkronja “a” Ndihma “de minimis” lejohet nëse nuk e kalon vlerën e përgjithshme 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh për një ndërmarrje të vetme.

16. Projektet që do të marrin ndihmë do të synojnë:

- përgatitjen e studimeve apo të modeleve të produkteve turistike;

- promovimin e destinacioneve turistike e të vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të vendit;

- edukimin profesional të burimeve njerëzore të subjekteve që zhvillojnë veprimtari në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e shërbimit.

17. Në ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”, neni 31, pika 4, përcaktohet se fondet për mbështetjen financiare për projektet në fushën e turizmit nuk i nënshtrohen legjislacionit të prokurimit publik. Dhënësi i ndihmës duhet të sigurojë mirëpërdorimin e fondeve publike, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë në fushën e turizmit dhe të trajtojë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese operatorët gjatë pjesëmarrjes në procesin e shqyrtimit të aplikimeve. Për këtë arsye, Komisioni vlerëson se është e nevojshme të rishikohet përmbajtja e njoftimit publik ku ftohen të marrin pjesë të gjithë të interesuarit për projekte në fushën e turizmit dhe se qartazi duhen përcaktuar edhe disa elementë shtesë, si p.sh., renditja e të gjithë përfituesve potencialë (ente publike/ndërmarrje) nga skema e ndihmës, kategorinë e aktiviteteve të cilat kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë, vlerën maksimale dhe minimale të mbështetjes me ndihmë shtetërore duke parashikuar në mënyrë të përafërt edhe numrin gjithsej të përfituesve të skemës, si edhe të listojë kostot e pranueshme për të cilat jepet ndihmë shtetërore.



18. Komisioni vlerëson se skema është hartuar për të nxitur zhvillimin ekonomik të rajonit në fushën e turizmit. Autoriteti zbatues i skemës do të raportojë të dhëna mbi baza vjetore lidhur me impaktin ekonomik të skemës në punësim, zhvillimin ekonomik etj. Gjithashtu, aplikimet për ndihmë do të merren përpara fillimit të zbatimit të projektit. Përfituesi duhet të ofrojë një kontribut minimal prej 50% të kostove të pranuarra e të miratuara nga dhënësi i ndihmës. Ndhimja në këtë skemë nuk do të jepet për ndërmarrjet në vështirësi.

Sa më lart, skema përmbushë kriteret për t'u konsideruar e lejueshme në bazë të nenit 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhimës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 13, 17, shkronja "ç", 22, pika 2/1, 30 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore nëpërmjet mbështetjes financiare të projekteve në sektorin e turizmit, të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.4.2016, "Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit", mbështetur në nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.

2. Dhënësi i ndihmës në njoftimin publik, ndër të tjera, duhet të përcaktojë edhe:

- përfituesit potencialë (ente publike/ndërmarrje) nga skema e ndihmës;
- kategorinë e aktiviteteve të cilat kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë;
- vlerën minimale dhe maksimale të mbështetjes me ndihmë shtetërore; si edhe të,
- listojë kostot e pranueshme për të cilat jepet ndihmë shtetërore;

3. Në zbatim të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, dhënësi i ndihmës gjatë vlerësimit dhe miratimit të ndihmës për një ndërmarrjeje të vetme duhet të ketë parasysh dhe të informojë përfituesin e ndihmës se ndihma e marrë nuk do ta kalojë vlerën e përgjithshme prej 14 000 000

(katërbëdhjetë milionë) lekësh, për një periudhë financiare prej tre vjetësh për një ndërmarrje të vetme. Në rast të kundërt, ndihma konsiderohet e paligjshme.

4. Dhënësi i ndihmës, me qëllim rritjen e efikasitetit të ndihmës shtetërore, duhet të hartojë dhe të publikojë një mekanizëm që të përmbajë edhe indikatorë për matjen e performancës dhe impaktin e turizmit, si edhe të oportuniteteve ekonomike. Ky mekanizëm është i domosdoshëm për monitorimin dhe kontrollin e skemës ku duhet të jenë përfshirë elementet e mëposhtme:

- Përshkrimi i detajuar i kostove të pranueshme;
- Dorëzimi i raporteve financiare;
- Monitorimi i ndihmës së dhënë, sidomos me qëllim përmbushjen e objektivave për të cilët u miratua, si edhe përmbushja e termave të kontratës;
- Njohja e shpenzimeve vetëm kundrejt faturave;
- Kthimi i ndihmës në rast shkelje.

5. Çdo përfitues ndihme duhet të nënshkruajë deklaratën e ndihmës "De Minimis" (bashkëlidhur) dhe të dorëzojë një kopje të deklaratës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Turizmit dhe një kopje pranë Komisionit të Ndhimës Shtetërore.

6. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në cilësinë e dhënësit të ndihmës, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

7. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

8. MZHETTS-ja, bazuar në nenin 20, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së në rastin eventual të çdo ndryshimi të skemës së njoftuar.

9. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Milva Ekonomi

**VENDIM****Nr. 44, datë 14.10.2016****PËR LICENCIM PËR HERË TË PARË
PËR SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME
VORË**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë, me:

Drejtues ligjor: Aldo Sheshaj

Drejtues teknik: Agim Koraçe

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Vorë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

**KRYETARI
Ndriçim Shani**

VENDIM**Nr. 45, datë 14.10.2016****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 21, DATË 30.4.2013, “PËR RINOVIM
LICENCE SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME DELVINË”**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

Faqe | 25450

VENDOSI:

Në vendimin nr. 21, datë 30.4.2013, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë” bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:

Drejtues ligjor: Bati Çuçuri

**KRYETARI
Ndriçim Shani**

VENDIM**Nr. 49, datë 2.12.2016****PËR LICENCIMIN PËR HERË TË PARË
TË SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME
BELSH**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Belsh, me:

Drejtues ligjor: Halit Senja

Drejtues teknik: Ndriçim Sinani

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Belsh autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Belsh.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

**KRYETARI
Ndriçim Shani**



VENDIM
Nr. 50, datë 2.12.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 20, DATË 30.4.2013, “PËR RINOVIM
LICENCE SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME MAT”

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 20, datë 30.4.2013, “Për rinovim licence sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Mat” bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:
Drejtues ligjor: Arjan Lika

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 51, datë 2.12.2016

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS
MALËSI E MADHE

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës Malësi e Madhe, me:

Drejtues ligjor : Flauers Shoshaj

Drejtues teknik: Rudi Beci

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës Malësi e Madhe autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Malësi e Madhe.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare)..

KRYETARI
Ndriçim Shani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë